



Partia Demokratike

SEKRETARIATI ORGANIZATIV SEKRETARIATI PËR PUSHTETIN LOKAL

Nr. 1 prot.

Tiranë, më: 06.08.2026

UDHËZIM

Nr. 1, datë 06.08.2026

“MBI ORGANIZIMIN DHE MBËSHTETJEN E QËNDRESES QYTETARE PËR MOSAPROVIMIN E PROJEKTIT QEVERTAR PËR ZVOGELIMIN E BASHKIVE”

Ky udhëzim ka për objekt organizimin dhe mbështetjen e qëndresës qytetare për mos aprovimin e projektit qeveritar për zvogëlimin e numrit të Bashkive.

Në gjithë territorin e vendit, kanë shpërthyer protestat kundër shkrirjes së bashkive, vecanerisht në 15 bashkitë që suspendohen me Projektligjin e PS-së të Reformës Administrative e Territoriale 2026. Partia Demokratike kundërshton me forcë projektin Rama për shpopullimin e vendit dhe rrëmbimin prej tij e të gjitha pushteteve në Shqipëri! Qëndresa e qytetarëve kundër shkrirjes së bashkive po dëshmon se kjo nuk është thjesht një betejë politike, por një kauzë qytetare në mbrojtje të territoreve të veta dhe vetëqeverisjes vendore.

PD qëndron në krah të qytetarëve dhe do të përdorë të gjitha mjetet demokratike për të mbrojtur të drejtën e tyre për vetëqeverisje dhe ekzistencë!

PD ka përgatitur ndërkohë një alternative shumë të mirë për ndarjen territoriale, e cila e shton numrin e bashkive nga 61 në 100 bashki, duke ofruar bashkitë dhe shërbimet e saj sa më pranë qytetarëve.

Per kete qellim,

UDHËZOJMË:

1. Të gjitha degët e PD duhet të mbledhen urgjentisht brenda kësaj jave, së bashku me këshilltarët demokrat të bashkive për të përgatitur kundërshtimin dhe për të bashkërenduar qëndrimin tonë protestues me gjithë qytetarët dhe grupet e interesit në cdo bashki.
2. Pranë cdo Këshilli Bashkie ka mbëritur nga Kuvendi Projektligji 'Për ndarjen e re Administrative e territoriale', nëpërmjet shkresës nr. 3573.
Për të qenë argumentues cdo degë ta kerkojë Projektligjin e PS dhe të përgatisë kundërshtimin dhe betejën mediatike dhe drejtpërdrejt me opinionin qytetar.

4. Në këtë ballafaqim Këshilltarët tanë bashkiak do të kërkojnë mirëkuptim dhe aleancë me cdo këshilltar tjetër të përgjegjshëm që kundërshton shkrirjen e bashkive,
5. Ata do ti bëjnë bejnë thirrje ndërgjegjies dhe vetëdijes së cdo këshilltari bashkiak, të përfaqësoj interesat e bashkësisë së qytetarëve që e kanë votuar dhe jo paranojës që po u shkatërron vendlindjet!
6. Në bashkitë të cilat nuk shkrihen, këshilltarët tanë do të solidarizohen me kërkesën e 15 bashkive dhe do të denoncojnë synimin e Ramës për të krijuar përçarje kombëtare.
7. Këshilltarët tanë duhet të sqarojnë kolegët e tyre që projekti I Ramës nuk vlen për askënd nëse qytetarët e njëjës që shkrihet nuk janë dakotrd. Kjo në bazë të Kushtetutës dhe Kartës evropiane të Vetqeverisjes Vendore.
8. Degët e PD do ti bëjnë thirrje gjithë antarëve të organizojnë dhe mbështetin cdo protestat qytetare.

Bashkitë u përkasin qytetarëve dhe nuk janë instrumente të pushtetit qendror.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI ORGANIZATIV

KLEVIS BALLIU

SEKRETARI PËR PUSHTETIN LOKAL

YLLI ASLLANI

